



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 3037/1 prot.

Tiranë, më 11.12.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi dy projektudhëzimet e përbashkëta

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 5242/1 prot., datë 19.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3037 prot., datë 21.11.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim “*dy projektudhëzimet e përbashkëta të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Punëve të Brendshme*” në zbatim të pikës 3, të nenit 36 dhe pikës 2, të nenit 38 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”.

Nga shqyrtimi i projektudhëzimeve të dërguara, Zyra e Komisionerit vlerëson marrjen në konsideratë të sugjerimeve të dhëna nga ana jonë dhe angazhimin e treguar nga ana e grupit të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjatë hartimit të këtyre akteve.

Sikurse jeni në dijeni, hartimi i këtyre projektudhëzimeve ka qenë një proces i vazhdueshëm dhe produktiv, i realizuar me kontributin e një grupi pune të ngritur me përfaqësues të Zyrës së Komisionerit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe variantet e dërguara janë dakordësuar paraprakisht në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit në përputhje të dy legjislacioneve respektive.

Megjithatë, konstatojmë se disa prej dispozitave kanë pësuar ndryshime, të cilat nuk janë në përputhje me variantet e dakordësuar paraprakisht nga grupi i punës. Me qëllim që këto projektudhëzime të jenë në të njëjtën linjë me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale, vlerësojmë nevojën e disa saktësimeve dhe plotësimeve, të cilat i dërgojmë, si më poshtë vijon.

Mbi ***projektudhëzimin e përbashkët “Për përcaktimin e rregullave, trajtimit, administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave personale të mbledhura nga policia”***, i

hartuar në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit” (në vijim, “Ligji nr. 82/2024”), sugjerojmë:

- **Në nenin 3 të projektudhëzimit**, germa “ç”, e pikës 1, të riformulohet sipas pikës 1, të nenit 75 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji nr. 124/2024”), me këtë përmbajtje: *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti mbikëqyrës i pavarur dhe përgjegjës për monitorimin e mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale”*.

Gjithashtu, po në këtë nen të shtohet një germë e re, ku të specifikohet përkufizimi i anonimizimit, si një nga proceset përpunuese që kryhet nga strukturat e Policisë së Shtetit, me këtë përmbajtje: *“Anonimizim” është procesi i përpunimit të të dhënave personale duke përdorur një grup teknikash që e bëjnë të pamundur identifikimin e një personi me çfarëdo mjeti. Të dhënat do të konsiderohen të anonimizuara në mënyrë efektive nëse subjektet e të dhënave personale, nuk bëhen më të identifikueshëm.*

- **Në nenin 6 të projektudhëzimit** përcaktohen kategoritë e të dhënave personale të përpunuara gjatë veprimtarisë policore. Nga shqyrtimi i këtij neni, vërejmë se gerrat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, i referohen në mënyrë të përgjithshme, përkufizimeve të pikave 24-29, të nenit 5 të Ligjit nr.124/2024. Gjithashtu, pika 1 e këtij neni, parashikon vetëm të dhënat personale të cilat përpunohen në zbatim të nenit 36, të Ligjit nr. 82/2024. Duke qenë se neni i sipërcituar i referohet vetëm të dhënave të mbledhura gjatë procesit të ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit, dhe arrestimit të personit (për të cilin është hartuar edhe projektudhëzimi përkatës), sugjerojmë që, **në nenin 6 të këtij projektudhëzimi** të parashikohen në mënyrë konkrete të dhënat personale që përpunohen për qëllime policore.

Mbështetur në parashikimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, vlerësojmë që, kategoritë e të dhënave personale duhet të përcaktohen duke specifikuar për secilën kategori, sa dhe cilat të dhëna personale, do të përpunohen e që janë të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e Policisë së Shtetit. Përcaktimi i kategorive specifike të të dhënave personale duhet të realizohet në harmoni me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin dhe parimin e minimizimit të të dhënave, të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të nenit 6 të Ligjit nr.124/2024, sipas të cilave të dhënat personale mblidhen për një qëllim specifik e të ligjshëm, si dhe të kufizuara në masën që është e nevojshme për realizimin e qëllimit.

- Në vijim, me qëllim parashikimin në mënyrë të qartë dhe konkrete, si dhe bazuar në Kapitullin III, të Pjesës III të Ligjit nr.124/2024, propozojmë që **neni 7 i projektudhëzimit**, të riformulohet me përmbajtje, si vijon:

Neni 7

Të drejtat e subjekteve të të dhënave

“Subjektet, të dhënat personale të të cilëve përpunohen nga Policia e Shtetit, gëzojnë të drejtat për informim, akses, korrigjim, fshirje ose kufizim të përpunimit, si dhe të drejtën për rishikimin e përgjigjes, sipas Ligjit nr.124/2024, me kufizime të lejuara vetëm në raste të përcaktuara qartë nga ky ligj”.

- Për sa i përket konfidencialitetit të të dhënave, Zyra e Komisionerit, sjell në vëmendje se, përtej parashikimeve të Ligjit, është e nevojshme përshtatja me veprimtarinë dhe kuadrin rregullator që zbatohet nga strukturat e Policisë së Shtetit. Për këtë arsye, bazuar në parashikimet e pikës 6, të nenit 6 dhe nenit 30 të Ligjit nr.124/2024, sugjerojmë riformulimin e **nenit 11 të projektudhëzimit**, me përmbajtje, si vijon:

Neni 11

“Të gjitha strukturat policore, personat dhe punonjësit që zbatojnë këtë udhëzim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave të përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, edhe pas përfundimit të funksionit”.

- Në vijim, ju sjellim në vëmendje se, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti i pavarur që monitoron e mbikëqyr të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale nga strukturat e Policisë së Shtetit. Në këtë kuadër, sugjerojmë riformulimin e **nenit 14 të projektudhëzimit**, me përmbajtje:

Neni 14

“Ngarkohen strukturat e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi”.

Sa i përket **projektudhëzimit të përbashkët “Mënyra e organizimit, administrimit, afatit të ruajtjes, kontrollit dhe fshirjes së të dhënave të mbledhura në rastet e ndalimit të përkohshëm policor, ndalimit dhe arrestimit të personave”**, i hartuar në zbatim të pikës 3, të nenit 36 të Ligjit nr. 82/2024, sugjerojmë si vijon:

- Zyra e Komisionerit sugjeron që, në përputhje me pikat 16 dhe 19, të nenit 5 të Ligjit, gjerat “a” dhe “f”, në pikën 1, të nenit 2 të projektudhëzimit, të saktësohen si vijon:

“a) “Përpunimi i të dhënave personale për qëllime policore” është përpunimi i të dhënave personale nga Policia e Shtetit, me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale, mbrojtjen dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë publike duke përfshirë operacionet policore (që kryhen me të dhënat personale ose grupe të të dhënave personale, me mjete automatike ose jo) si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, deklarimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njehsimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi”.

“f) “Profilizimi i të dhënave” i referohet përpunimit të automatizuar të të dhënave personale për të vlerësuar karakteristikat e një individi, siç janë sjellja, preferencat ose vendndodhja e tij, për të parashikuar ose analizuar aspekte të personalitetit ose performancës së tij. Kjo përfshin përdorimin e të dhënave për të marrë vendime që ndikojnë ndjeshëm tek jeta private e individit.

- Me qëllim garantimin e të gjitha të drejtave ligjore të subjekteve të të dhënave, që parashikon Ligji nr.124/2024, sugjerojmë që, **pika 1, e nenit 6 të projektudhëzimit** të riformulohet me përmbajtje:

“1. Subjektet, të dhënat personale të të cilëve përpunohen nga Policia e Shtetit, gëzojnë të drejtat për informim, akses, korrigjim, fshirje ose kufizim të përpunimit, si dhe të drejtën për rishikimin e përgjigjes, sipas Ligjit nr.124/2024”.

- Më tej, sikurse në projektudhëzimin si më lart, bazuar edhe në argumentimin ligjor lidhur me nenin “zbatimi”, sugjerojmë riformulimin e **nenit 19 të këtij projektudhëzimi**, me këtë përmbajtje:

Neni 19

“Ngarkohen strukturat e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi”.

Në përfundim me reflektimin e propozimeve të sipërpërmendura, projektudhëzimet e përbashkëta vlerësohen të hartuara në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi